Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Gjemajli Bellanica	23.03.2022	04.04.2022	*63-64/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.03.2022 OE "**Trendy Home**" sh.p.k Prizren dhe OE "**MOBELLAND**" Sh.p.k Suharekë**,** kanë parashtruar ankesë me nr.**63;64/22** kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "**Furnizim me Inventar për KGJK dhe Gjykata**", me nr. të prokurimit: **328-21-9410-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KGJK **.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar kontratë publike kornizë, Procedurë e Hapur, Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 500 000,00 €

Data e njoftimit për kontratë.....25.11.2021.
Hapja e ofertave.....18.01.2022.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së.....01.03.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....07.03.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....09.03.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE "**Trendy Home**" sh.p.k Prizren dhe OE "**MOBELLAND**" Sh.p.k Suharekë

Dispozitat e shkelura të OE "**Trendy Home**" sh.p.k Prizren dhe OE "**MOBELLAND**" Sh.p.k Suharekë

Neni - 1
Neni – 7 paragrafi 1,2,3,4,6
Neni – 27 Dosja e Tenderit
Neni – 28 Specifikimet teknike
Neni – 59 paragrafi 2,4,5
Neni – 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
Neni - 18 i RROUPP
Neni - 44 i RROUPP
Neni - 4 i Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet të OE "**Trendy Home**" sh.p.k Prizren

Neni 1 – paragrafi 1 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 1
Qëllimi

- Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS me vendimin për anulim ofertën tonë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, dhe ne si OE i përgjegjshëm jemi të diskriminuar.. Andaj AK për aktiviteti të prokurimit në fjalë nuk ka trajtuar në parim ligjet, rregullat dhe udhëzimet e LPP.

Neni 7 – paragrafi 1,2,3,4,6 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS me vendimin për ta anuluar këtë aktivitet të prokurimit, edhe pse ofertën tonë ta trajtoj si të papërgjegjshme, AK nuk i ka trajtuar ofertat në mënyrë të barabarte dhe në harmoni me paragrafët e larte cekura te nenit 7 te LPP. Pasi ne si OE "TRENDY HOME" sh.p.k. jemi të diskriminuar dhe se ne jemi oferte e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit dhe se KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS ne si OE na ka diskualifikuar padrejtësisht, dhe se ne si OE jemi oferte me çmimin më të ulët si e përgjegjshme që plotësojmë të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë .
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS me vendimin për anulim te ofertës sonë për ketë aktivitetit të prokurimit na ka diskriminuar neve si OE ne kete aktivitet te prokurimit.

Neni 59 – paragrafi 2, 4, 5- Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 59
Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

4, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

5. Përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34, 35 të këtij ligji dhe paragrafi 2. dhe 3. i këtij neni, asnjë komunikim, diskutim ose negociatë e çfarëdo lloji nuk mund të mbahen ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një operatori ekonomik, në lidhje me një tender të dorëzuar.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:
Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozite ligjore, nuk ka kryer ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në përputhje me këtë dispozitë bazuar në kërkesat tek njoftimi për kontrate dhe dosje te tenderit. KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, përkundër qe ne si OE kemi sqaruar të gjitha paqartësitë lidhur me aktivitetin e prokurimit dhe çmimet tona të cilat i kemi sqaruar ne detale se ne nuk kemi çmime jo normalisht të ulëta.
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS të gjitha dokumentacionet e dosjes së tenderit duhet ti vlerësoj si të tilla siç janë dorëzuar nga, të njëjtat nuk mundë as të ndryshohen, tërhiqen, shtohen apo modifikohen, por mundë të sqarohen ne detale për të gjitha ato paqartësi të cilat mundë të jen tek komisioni i vlerësimit dhe tek AK. . Andaj KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS vlerësimin duhet ta kryej në përputhje me dokumentacionin e ofruar i cili gjendet në dosjen e tenderi të dorëzuar nga ne.
Dhe se pretendimet e AK që sqarimet janë të pamjaftueshme nuk qëndrojnë. Ne kemi paraqitur për secilin pozicion të kërkuar nga AK-KGJK ne detale të gjitha furnizimet, përpunimet, stafin punues dhe kemi kosto e cila është me e ulët se çmimi të cilin ne kemi aplikuar. Andaj AK-KGJK nuk mund të llogarisë çmimet tona si çmime jo normalisht të ulëta, dhe se pretendimet e AK-KGJK se ne si OE TRENDY HOME kemi çmime jo normalisht të ulëta në disa pozicione (pozicioni 8 dhe 17) si dhe çmime shumë të larta në raport me çmimet e tregut nuk qëndrojnë.

DEKLARATË

TAVOLINA E TAKIMEVE PËR 22 PERSONA

Artikulli me numër rendor 8-(materiali shpenzues)

- MDF -17,075 m² =2.919 pllaka 68.26 € – ------- 199.30 €
- Elemente lidhese---------- 52x0.075 3.90 €
- Profil metali---------- 33.6m¹x2.09 70.20 €
- Shpenzimet punes ---------- 66.00 €
- Fitimi ---------- 40.60 €
- Total qmimi ofertues nga Trendy Home--------- 380.00 €

PROCESI I PRODHIMIT

Në procesin e prodhimit të produktit janë të angazhuar si fuqia teknike-makineria e sofistikuar të cilat i kemi ne dispozicion në repartin e prodhimit,gjatë procesit per artikullin të lartëcekur gjithashtu janë të angazhuar 2 operator prodhimi.

Kohezgjatja e finalizimit të produktit është rreth 5 ore e 30 min.Përshkrimi i procesit të prodhimit është përpiluar në bazë të specifikave momentale nga ana e KGJK ,

22-PSV01-001-1

"Arben Daliku "-B.I - NTSH B&M ELECTRONICS

Nrf:600017405 NUI:811287318 Tvsh:330021478
tel:044 128 778 -Rr" Nëna Tereze"-GJAKOVË
email:beni69@hotmail.com
1140156670000117- PCB 2018-0000-114-024-28TEB 1930377611031229 8KT

Malli dergohet me:

Oferta dergohet me:

TRENDY HOME SHPK

Qyteti: Prizren

No fakal: 600131283

Numri unik: 810968547

No TVSH: 330056904

Data	Kushtet	Validiteti	Referenca	Referenti juaj	Lokacioni
15.01.2022		15.01.2022			001

No	Kodi	Emertimi	Sasia	Njësia	Cmimi pa TVSH	Rabati %	TVSH %	Cmimi me TVSH	Vlera me TVSH
1	702	BEKO REF TSE 1410	1.00	Copë	138.98	0.00	18.00	164.00	164.00

Vlera pa TVSH : 138.98

Rabati : 0.00

TVSH : 25.02

Vlera per pagese: 164.00 EUR

NTP AKOMA TE ISAKU

OFERTE

TRENDY HOME SH.P.K. Emri: Adresa: Prizren, Lupishtë Nr Unik: 810968547	Adresa: Magjistralja PrishtinëFerizaj,Km5,Preoce,10500 Nr Unik: 811311373

DATE: 15.01.2022

Shifra	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Totali
423	Orman metalik FC-4C 452*620*1331	Cope	1	164	164.00
1536	Ormana metalik FC-18A (185x90x40)	Cope	1	180	180.00

FATURA TATIMORE

Numer	Muaji/data /viti
7000288	2/15/2022

Bleresi: *Trendy Home sh.p,k*

000052 *N.U.I 810968547*

Prizeren

FORUM Shpk

N.U.I.810745937 / 600644696

PEJË

TEB Bank 2015000142683736

NLB Bank 1706001011994853

Derguar:

Deri te: *Trendy Home sh.p,k*

Page 1

Kodi	Pershkrimi	Sasia	Qmimi	Zbritje	Shuma
040	Mdf 18x122x280 akrilik	1	68.26	0	68.26
007	Iverica 18x207x280 me struktur	5	33.34	0	166.70
005	Iverica 18x207x280 me ngjyre	6	40.07	0	240.42

NE SI OE TRENY HOME, kemi çmime në përputhje me kërkesat në njoftimin në kontratë, dosjen e tenderit dhe çmime të tregut. Si dhe nuk kemi askund çmime jo-normalisht të ulëta dhe as çmime shumë të larta.

OE Mobelland" SH.P.K. të gjeturat

Sa i përket rafteve metalike, ka çmime të cilat nuk janë çmime as të furnizimit dhe dokumentacioni apo oferta nuk i plotëson të gjitha elementet për të qenë autentik. (nuk posedon vulë, nuk posedon shifër të artikullit për pozicionet Orman metalik, Kasteta metalike, si dhe çmimet e tyre janë çmime manipuluese.

NTP AKOMA TE ISAKU

OFERTE

Emri:	MOBELLAND SHPK	Adresa:	
Adresa:	Xhavit Sylaj p.n.	Magistrala PrishtinëFerizaj,Km5,Preose,10500	
Nr Unik:	810107393	Nr Unik: 811311373	
DATE: 15.12.2021			

Shifra	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Totali
5176	Karrika Z16C (Orgonmetrike)	Cope	1	190.00	190.00
6555	Karrika 909 (Statike per pale)	Cope	1	90.00	90.00
	Ormana metali	Cope	1	28.00	28.00
	Kaseta metali	Cope	1	26.00	26.00
					334.00

OE Mobelland" SH.P.K. të gjeturat (materialet)
Ka dërguar oferta dhe fatura të cilat data e tyre është viteve 2019/2020 dhe nuk jan çmime aktuale, si dhe në faturat edërguara nuk ka ofruar materialet sipas kërkes në specifikim teknik Aneksi 1 (MDF, por ka ofruar çmime për artikuj tjerë si Ivericë e thjeshte, dru nga kompania MARLES etj.

OE Mobelland" SH.P.K. të gjeturat (Frigorifer)
OE Mobelland, ka paraqitur një oferte për Frigorifer me çmim 20.00 euro, çmim ky i cili është jonormalisht i ulet, dhe se oferta e dërguar për kete artikull është oferte ne letër te thjeste, pa vule, dhe se ky çmim nuk është çmim i tregut.


OFERTA

Nr. ren.	Përshkrimi i mallrave dhe i shërbimeve				
1.	FRIGORIFER		1		20

Neni 61 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lagjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 61
Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:

   2.1. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

   2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

   2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

   2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

3. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.

4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.

5. Autoriteti kontraktues është i obliguar për të njoftuar KRPP-në brenda dy ditëve që nga data e ndonjë refuzimi nën nenin paragrafit 4. të këtij neni. Njoftimi duhet të ofrojë informacionin, shpjegimet dhe arsyet e përmendura në atë nen.

6. KRPP-ja nxjerr akt nënligjor për rregullimin në hollësi për përcaktimin e çmimit jonormalisht të ulët.

Deklarata, Faktet dhe argumentet:

Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozite ligjore, nuk ka kryer ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në përputhje me këtë dispozitë bazuar në kërkesat tek njoftimi për kontrate dhe dosje te tenderit si dhe në rregullat për tenderët jo normalisht të ulët. Ne si OE Trendy Home , kemi çmime të cilat nuk janë çmime jo-normalisht të ulëta dhe as çmime jo normalisht të larta, por janë çmime të tregut të cilat mund të verifikohen tek bashkëpunëtoret dhe partnerët tanë, ku ju kemi dërguar dëshmitë sipas kërkesës për sqarimetë tenderit.

Përmbledhje (Konkluzion)

Kërkojmë nga ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

1. **Lënda të kthehet në Ri-Vlerësim nga OSHP,**
2. **Ofertën tonë ta trajtoj në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Ligjit të Prokurimit Publik në fuqi dhe se ta rishqyrtoj vendimin e AK për këtë aktivitetit të prokurimit të dt. 01.03.2022 dhe ne si OE "TRENDY HOME" shpk te shpërblehemi me njoftimin për dhënie të kontratës. Ngase ne jemi OE i përgjegjshëm me çmimin me te ulet sipas kërkesave në njoftimin e kontratës, dosjes se tenderit dhe rregullave dhe ligjeve në fuqi të LPP.**

Nëse ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT nuk ndërmerr hapa konkret, dhe ofertën tonë ta trajtoj në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Ligjit të Prokurimit Publik ne kërkesën tonë do ta dërgojmë në instanca më të larta të cilat janë të specifikuara me ligji për të drejtën tonë e cila na takon domosdoshmërish nëse respektojmë ligjet dhe rregulloret në fuqi.

<u>Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet</u> OE " MOBELLAND" Sh.p.k Suharekë

Autoriteti Kontraktues ka shpallur tenderin në fjalë në të cilin ka paraqitur kërkesat për pjesëmarrje si dhe ka paraqitur kriterin për dhënie i cili ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët në bazë të poentimit.
Duke pasur parasysh specifikacionin teknik minimal të cilin e ka kërkuar Autoriteti Kontraktues, kemi dhënë çmimin si dhe kemi paraqitur katalogun me specifika teknike. Të gjithë O.E. pjesëmarrës kanë ofruar çmime përafërsisht të njejta ndërsa ne kemi dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët në mesin e tenderuesve pjesëmarrës. Autoriteti Kontraktues Sekretariati i Këshillit Gjyqësor na ka shpallur si të pa përgjegjshëm me arësyetimin se sqarimet tona të ofruara të datës 26.01.2022 nuk janë të mjaftueshme dhe nuk

arësyetojnë çmimet jo-normalisht të ulëta në shumë pozicione dhe çmimet shumë të larta në raport me çmimet e tregut.
Gjithashtu ka cekur se në shumicën e pozicioneve (të specifikuara edhe në letrën standarde për informata sqaruese keni ofruar çmime spekulative respektivisht çmime jo normalisht të ulëta apo çmime shumë të larta në raport me çmimet e tregut në kundërshtim me nenin 61 të LPP-s Çmimi jo normalisht i ulët dhe nenin 4 të RRUOP-s pika 4.2 të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Konsiderojmë që konkluzioni i Autoritetit Kontraktues i paraqitur më lartë është vetëm arësyetim fiktiv me të cilin Autoriteti Kontraktues me rastin e vlerësimit të tenderit, duke parë që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, si dhe kemi ofruar çmimin e tenderit më të lirë në mesin e ternderuesve pjesëmarrës, me qëllim që tia jep edhe një shansë ndonjë O.E. të paracaktur, na shpall të pa përgjegjshëm dhe anulon tenderin në fjalë. Andaj del se Autoriteti Kontraktues, gjatë vlerësimit të tenderit nuk i ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese si dhe nuk ka vepruar në mënyrë transparente. Mendojmë se autoriteti kontraktues ka pasur qëllime tendencioze në mënyrë që përmes refuzimit të tenderit tonë si dhe anulimit të tenderit ta ritenderoj procedurën në fjalë në mënyrë që t'ia mundësoj edhe një shansë ndonjë O.E. tjetër i cili ka ofruar një çmim më të lartë se ne dhe ta shpërblejë me kontratë, andaj kjo paraqet shkelje të nenit shtatë (7) të LPP-së.

Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 1 të LPP-s pasi që ka refuzuar ofertë tonë e cila ka qenë ofertë më e lirë ndërsa dispozitat e këtij neni kanë paraparë që qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Në bazë të këtyre dispozitave Autoriteti Kontraktues duhet ta merr vlerën për paranë e që oferta jonë do ta plotësonte një kërkesë të tillë.

Komisioni i vlerësimit është caktuar me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës z Shkelzen Maliqi. Në komision të vlerësimit janë emëruar: Ilaz Papaj Kryesues, Alban Nuredini anëtar dhe Gëzim Kurshumliu anëtar. Pasi analizuam vendimin, vërejtëm që i njejti është i mangët dhe në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të prokurimt pasi që në pikën 1 të vendimit anëtarët e komisionit janë caktuar në bazë të pozitave të punës dhe jo në bazë të profesionit të cilin e zotërojnë. Në nenin 40 të RRUOP në pikën 40.5 është paraparë që Komisioni do të përbëhet nga anëtar me aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë, relevante me kërkesat e prokurimit. Gjithashtu neni 2 i vendimit, përmes të cilit i caktohen detyrat e komisionit është në kundërshtim me nenin 1 pasi që në nenin 1 është thënë se prokurmi është zhvilluar përmes procedurës së hapur ndërsa në nenin 2 është cekur se komisioni dueht ti kryej detyra në bazë të nenit 35 e që ka të bëjë me Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës.

Në raportin e vlerësimit të tenderit si dhe në vendimin e Autoritetit Kontraktues, komisioni vlerësues nuk ka dhënë kurrëfarë sqarimi si dhe nuk ka bërë kurrfarë analize për të dëshmuar se si ka ardhur deri te konkluzioni që ne kemi ofruar tender jo normalisht të ulët apo se kemi ofruar çmim të lartë në disa artikuj. Gjithashtu komisioni nuk ka dhënë kurrfarë sqarimi se me cilin treg i ka krahasuar çmimet tona, apo nga cilat referenca të tregut i ka marrë çmimet për ti krahasuar me ofertën tonë.

Në bazë të Rregullave për tenderët jo normalisht të ulët, në neni 4.4 është paraparë që gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulet, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsiderate:

4.4.1 ekonominë e procesit të prodhimtarisë,
4.4.2 çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
4.4.3 çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, dhe
4.4.4 origjinalitetin e furnizimeve.

Komisioni vlerësues i ka shkelur këto rregulla, pasi që nuk ka ofruar kurrfarë dëshmie se ka marrë për bazë ekonominë e procesit të prodhimtarisë të inventarit të kërkuar, nuk i ka marrë për bazë zgjidhjet teknike të ofruara nga ne, nuk i ka marrë për bazë kushtet veçanërisht të favorshme që janë në dispozicionin tonë për furnizimin e produkteve si prodhues i të gjithë inventarit të kërkuar si dhe nuk e ka marrë për bazë origjinalitetin e furnizimeve.

Përkundër kësaj ne si Operator Ekonomik, në bazë të kërkes së Autoritetit Kontraktues për sqarimin e tenderit, ne në mënyrë profesionale i kemi elaboruar çmimet tona të cilat i kemi ofruar në tender, duke dhënë të gjitha informatat si dhe duke ndarë të gjithë procesin që nga furnizimi i materialit, prodhimin, transportin, shpenzimet, fitimin dhe tatimin. Gjithashtu për çdo artikull kemi ofruar dëshmi se si ka ardhur deri tek çmimi i dhënë në tender. Kemi paraqitur kushtet veçanërisht të favorshme që janë në dispozicionin tonë për furnizimin e produkteve si dhe kemi ofruar dëshmi të origjinalitetit të prodhimeve tona. Andaj, konkluzioni se sqarimet tona nuk janë të mjaftueshme dhe nuk arësyetojnë çmimet jo normalisht të ulëta në shumë pozicione dhe shumë të larta në raport me çmimet e tregut është vetëm konkluzion fiktiv për të na diskualifikuar pasi që në njërën anë, nuk janë marrë për bazë sqarimet tona ndërsa në anën tjetër komisioni nuk ka bërë kurrfarë vlerësimi apo ekspertize në lidhje me çmimet e ofruara nga ana jonë edhe pse kanë qenë të obliguar me dispozita ligjore.

Në specifikat e tenderit Autoriteti Kontraktues ka kërkuar materiale tepër të veçanta psh në artikullin 21- Vitrine me 2 dyer për zyre është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që pesha specifike e vitrinës të jetë 850kg/m³ Duke pasur parasysh këtë kërkesë edhe pse kjo vitrinë është me dimensione më të vogla se pozicioni 19 dhe 20 materiali i ndërtimit është 15 fish më i shtrenjtë për shkak të nevojës të presimit tepër të lartë të materialit pët ta arritur peshën specifike të kërkuar. Prandaj është normale që kur kërkohet një material me specifika të tilla, çmimi do të del më i lartë se disa artikuj tjerë për të cilat janë kërkuar specifika të rëndomta. Pra në bazë të specifikave të kërkuara nga vet Autoriteti Kontraktues janë dhënë edhe çmimet. Gjithashtu ka pasur edhe artikuj tjerë të cilët në bazë të specifikave të veçanta është dashur që të ofrohen çmimet në bazë të materialit në tregun e inventarit. Andaj, Autoriteti Kontraktues ka bërë edhe shkelje të nenit 27 të LPP-s paragrafi 1 dhe Nenit 18 të Rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit.

Duhet të theksojmë që ne kemi kontrata në realizim e sipër si dhe kemi ekzekutuar kontrata në vitet e kaluara me të cilat kemi bërë furnizime të inventarit në Autoritetet Kontraktuese si Presidenca e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës si dhe në shumë autoritete tjera. Nëse shikohen kontratat e më parshme çmimet janë përafërsiht të njejta në përjashtim të artikujve për të cilat janë kërkuar specifika të veçanta. Kontrata me Sekretariatin e Këshillit Gjyqësor për furnizim me inventar, është përmbushur me sukses dhe nuk kemi pasur kurrfarë ankese nga Autoriteti Kontraktues, por kemi pranuar referencën për përmbushje me sukses dhe korrektësi të kontratës. Komisioni vlerësues është dashur që ta merr për bazë edhe këtë fakt me rastin e vlerësimit të tenderit pasi që çmimet janë të njejta. Autoritetin Kontraktues me datën 14.01.2022 e kemi furnizuar me të njejtat çmime të paraqitura në tenderin tonë me 60 copë tavolina për të cilat nuk kemi pasur vërejtje, ndërsa sqarimin tonë nuk e kenë pranuar si të mirëqenë, pasi që kanë cekur se çmimet janë jo normalisht të ulëta dhe se sqarimet tona nuk janë të mjaftueshme dhe nuk arësyetojnë çmimet jo-normalisht të ulëta.

Në bazët të fakteve të paraqitura më lartë, konsiderojmë që komisioni vlerësues, nuk e ka kryer detyrën e vetë në përshtatje me vendimin për caktimin e tyre pasi që ka bërë një vlerësim jo të drejtë dhe të njëanshëm të tenderit duke shkelur nenin 59 të LPP-s për arsye se ne i kemi dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë tek Autoriteti Kontraktues, ndërsa komisioni vlerësues na ka konsideruar si të pa përgjegjishëm dhe ka vlerësuar se tenderi duhet të anulohet.

Në dispozitat e nenit 62 të LPP-s si dhe në dispozitat e nenit 44 të Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit është paraparë ndërprerja e procedurave të prokurmit. Sipas këtyre dispozitave, në asnjërën nga pikat, nuk është paraparë që të anulohet tenderi pas hapjes së tijë për shkak të çmimeve jo normalisht të ulëta.

Në fund duhet të cekim që Autoriteti Kontraktues ka bërë edhe shkelje të dispozitave të nenit 61 të LPP-s si dhe nenit 4 pika 4.6 të Rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit pasi që pas sqrimit ka konsideruar që sqarimi jonë nuk mjafton, tenderin tone e ka anuluar dhe nuk e ka njoftuar KRPP-n, ne përputhje me nenin 61 te LPP-se, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim te tenderit abnormalisht te ulet", brenda dy dite nga data e vendimit sepse KRPP në bazë të kompetencave të veta ka mundur që ta hetoj këtë rast dhe të rekomandoj që mos të anulohet tenderi pasi që kemi ofruar sqarimin e mjaftueshëm për çmimet tona të paraqitur në tender dhe nuk dot të kishte ardhur deri te paraqitja e ankesës.

Në bazë të asaj që u tha më lartë konsiderojmë që anulimi është bërë në mënyrë tendencioze duke na diskriminuar neve, vetëm për t'ia dhënë shansën e dytë ndonjë Operatori Ekonomik të parazgjedhur, ndërsa sikur e kemi cekur edhe më lartë arësyetimi është vetëm justifikim fiktiv për ta anuluar këtë tender.

Duke u bazuar në nenin 106 të LPP-s, si dhe në rrethanat dhe faktet e cekura më lartë, kërkojmë nga OSHP që të urdhëroj Autoritetin Kontraktues, automatikisht ta pezulloj aktivitetin e prokurimit në fjalë, të shqyrtoj faktet e paraqitura në ankesën tonë dhe pas vërtetimit të fakteve të cekura më lartë ta urdhëroj Autoritetin Kontraktues që ta kthej tëndën në rivlerësim dhe të na shpërblen neve me kontratën në fjalë si Operator Ekonomik i cili ka dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmimn më të ulët .

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

Regjistrimi i OE në regjistrin profesional, komercial ose korporatës në vendin e themelimit

Regjistrimi i numrit fiskal

Regjistrimi i TVSH-se.

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

N/A

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Ofertuesi duhet të ofroj dëshmi se ka kontrata të përfunduara te natyrës se ngjashme ne tri vitet e shkuara nga Data e Publikimit të Njoftimit për Kontratë, vlera e përgjithshme monetare e furnizimeve për operatorin ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik jo më e vogël se 600,000.00 €.

Inventari te dëshmohet me fotografi për secilin artikuj (Përjashtimisht sallave te gjykimit dhe zyrave te shkrimoreve)

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit, me totalin e informatave
Kopja certifikatës së numrit fiskal
Kopja e certifikatës se TVSH-se

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare
N/A
Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale
Lista e kontratave te realizuara gjatë tri viteve te fundit se bashku me referenca apo raport te pranimit

Katalogu për artikujt e ofruar nga OE për secilin veç e veç te evidentohen sipas numrit rendor te tabelës

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Rezultati i aktivitetit te prokurimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës e anulon aktivitetin e prokurimit: **" Furnizim me Inventar për KGjK dhe Gjykata "**

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "Trendy Home" sh.p.k Prizren dhe OE " MOBELLAND" Sh.p.k Suharekë

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE "**Trendy Home**" sh.p.k Prizren

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues pretendon se është shkelur Neni 1 i LPP-së pasi Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendimin për anulimin e ofertës tonë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, dhe ne si OE i përgjegjshëm jemi diskriminuar. Andaj AK për aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk i ka trajtuar në parim ligjet, rregullat dhe udhëzimet e LPP-së.

Për këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se vendimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit nga AK-ja nuk do të nënkuptonte shkeljen e Nenit 1 të LPP-së, për faktin se AK-ja ka dhënë arsyetimin e saj lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit se asnjëri prej tenderëve të pranuara nuk është i përgjegjshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues konstaton që është shkelur Neni 7 i LPP-së pasi që AK-ja me vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe në harmoni me paragrafët e Nenit 7 të LPP-së, pasi ne jemi ofertë e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit dhe AK-ja na ka diskriminuar dhe diskualifikuar padrejtësisht, dhe se ne si OE jemi ofertë me çmim më të ulët si e përgjegjshme që plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Eksperti shqyrtues thekson se qëllimi i këtij neni është trajtimi i barabartë dhe jo diskriminues i të gjithë ofertave, andaj trajtimi i barabartë i OE ankues si i eliminuar nuk është diskriminues, për arsye se AK-ja iu ka kërkuar sqarime OE-ve për disa çmime për të cilat i ka konsideruar si jo normalisht të ulëta dhe të larta, dhe OE ankues i ka ofruar përgjigje AK-së e cila nuk ka rezultuar bindëse për AK-në.

Duke u bazuar në këtë fakt eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi i OE ankues që është shkelur Neni 7 i LPP-së është i pa bazuar, për faktin se AK-ja i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë Operatorët Ekonomik dhe të gjithëve iu ka kërkuar sqarime, duke iu dhënë mundësin që të japin shpjegimet e tyre për disa çmime në pozicione.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues konstaton se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, nuk ka kryer ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në përputhje me këtë dispozitë bazuar në kërkesat tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit, për kundër që ne si OE kemi sqaruar të gjitha paqartësitë lidhur me aktivitetin e prokurimit dhe çmimet tona të cilat i kemi sqaruar në detale se ne nuk kemi çmime jo normalisht të ulëta. Pretendimet e AK-së se sqarimet janë të pamjaftueshme nuk qëndrojnë, ne kemi paraqitur për secilin pozicion

të kërkuar nga AK në detale të gjitha furnizimet, përpunimet, stafin punues dhe kemi kosto e cila është më e ulët se çmimi të cilin ne kemi aplikuar. Andaj nuk mund të llogarisë çmimet tona si çmime jo normalisht të ulëta, dhe se pretendimet e AK-së se ne si OE "Trendy Home" kemi çmime të ulëta për disa pozicione (pozicioni 8 dhe 17) si dhe çmime shumë të larta në raport me çmimet e tregut nuk qëndrojnë.

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se me dt. 12.02.2022 AK-ja ka kërkuar sqarime nga OE ankues për çmime, për disa nga pozicionet të cilat AK-ja i ka konsideruar si çmim jo normalisht i ulët dhe çmim i lartë në krahasim me çmimin e tregut. Me dt.16.02.2022 janë ngarkuar në E prokurim dokumentacion (përgjigje) nga ana e OE ankues si Deklaratë për pozicionin 8 (tetë) të paramasës (Tavolin për takime për 22 persona) ku operatori ekonomik ka zbërthyer se si ka ardhur deri tek çmimi i ofruar. Në vijim gjeni të bashkangjitur deklaratën e OE.

TRENDY HOME
FABRIKA E MOBILJEVE - PRIZREN

Nr.Fiskal: 600131263-Nr unik: 810968547
Adresa: Lupishte ,PRIZREN Tel: 00 383 44 232927
Email:trendyhomeks@gmail.com

DEKLARATË

TAVOLINA E TAKIMEVE PËR 22 PERSONA

Artikulli me numër rendor 8-(materiali shpenzues)

- MDF -17,075 m² =2.919 pllaka 68.26 € -- ------- 199.30 €
- Elemente lidhese---------- 52x0.075 3.90 €
- Profil metali---------- 33.6m¹x2.09 70.20 €
- Shpenzimet punes ---------- 66.00 €
- Fitimi ---------- 40.60 €
- Total qmimi ofertues nga Trendy Home--------- 380.00 €

PROCESI I PRODHIMIT

Në procesin e prodhimit të produktit janë të angazhuar si fuqia teknike-makineria e sofistikuar të cilat i kemi ne dispozicion në repartin e prodhimit,gjatë procesit per artikullin të lartëcekur gjithashtu janë të angazhuar 2 operator prodhimi.

Kohezgjatja e finalizimit të produktit është rreth 5 ore e 30 min.Përshkrimi i procesit të prodhimit është përpiluar në bazë të specifikave momentale nga ana e KGJK ,

Dt: 15. 02. 2022

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "TRENDY HOME" SH.P.K. PRIZREN

"Trendy Home" SH.P.K -Prizren

Për pozicionin me nr.17 të paramasës OE ankues ka bashkangjitur faturë nga "NTSH B&M Electronics", po ashtu edhe për pozicionet 32 dhe 33 të paramasës OE ankues ka bashkangjitur një ofertë nga OE "NTP AKOMA TE ISAKU". Në vijim gjeni të bashkangjitura faturat për pozicionin 17, 32 dhe 33.

22-PSV01-001-1

"Arben Daliku "-B.I - NTSH B&M ELECTRONICS

Nrf:600017405 NUI:811287318 Tvsh:330021478
tel:044 128 778 -Rr" Nëna Tereze"-GJAKOVË
email:beni69@hotmail.com
1140156670000117- PCB 2018-0000-114-024-28TEB 1930377611031229BKT

Oferta dergohet ne:

TRENDY HOME SHPK

Qyteti: Prizren

No fiskal: 600131263
Numri unik: 810968547
No TVSH: 330056904

Malli dergohet ne:

Data	Kushtet	Validiteti	Referenca	Referenti juaj	Lokacioni
15.01.2022		15.01.2022			001

No	Kodi	Emertimi	Sasia	Njesia	Cmimi pa TVSH	Rabati %	TVSH %	Cmimi me TVSH	Vlera me TVSH
1	702	BEKO REF TSE 1410	1.00	Copë	138.98	0.00	18.00	164.00	164.00

Vlera pa TVSH : 138.98
Rabati : 0.00
TVSH : 25.02
Vlera per pagese: 164.00 EUR

NTP AKOMA TE ISAKU

OFERTE

Emri:	TRENDY HOME SH.P.K.	Adresa:	Magjistralja PrishtinëFerizaj,Km5,Preoce,10500
Adresa:	Prizren, Lupishtë	Nr Unik:	811311373
Nr Unik:	810968547		

DATE: 15.01.2022

Shifra	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Totali
423	Orman metalik FC-4C 452*620*1331	Cope	1	164	164.00
1536	Ormana metalik FC-18A (185x90x40)	Cope	1	180	180.00

Gjithashtu edhe për pozicionet me nr.39 dhe 41 të paramasës, OE ankues i ka zbërthyer në detale se si ka ardhur deri te çmimi i ofruar nga ana e tyre. Mirëpo këto arsyetime nuk janë konsideruara si të mirëqena nga ana e AK-së.

Duke pas parasysh që në dokumentacionin e ofruar në E prokurim nuk ka ndonjë dëshmi që AK-ja ka bërë verifikimin e këtyre çmimeve, eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit AK-ja të verifikoj çmimet e ofruara nga OE ankues me çmimet e tregut në mënyrë që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE ankues pretendon se OE "MOBELLAND" sh.p.k, sa i përket rafteve metalike, ka çmime të cilat nuk janë çmime as të furnizimit dhe dokumentacioni apo oferta nuk i plotëson të gjitha elementet për të qenë autentik. (nuk posedon vulë, nuk posedon shifër të artikullit për pozicionet Orman metalik, kaseta metalike, si dhe çmimet e tyre janë çmime manipuluese.

Gjithashtu OE "Mobelland" sh.p.k të gjeturat (materialet) ka dërguar oferta dhe fatura të cilat data e tyre është e viteve 2019/2020 dhe nuk janë çmime aktuale, si dhe në faturën e ofruar nuk ka dërguar materialet sipas specifikimit teknik Aneksi 1 (MDF), por ka ofruar çmime për artikujt tjerë si Ivericë e thjeshtë, dru nga kompania MARLES etj.

Po ashtu OE "Mobelland" sh.p.k të gjeturat (frigorifer), ka paraqitur një ofertë për frigorifer me çmim 20.00 euro, çmim ky i cili është jo normalisht i ulët, dhe se oferta e dërguar për këtë artikull është ofertë në letër të thjeshtë, pa vulë, dhe se ky çmim nuk është çmim i tregut.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se OE "Mobelland" në sqarimet e tij për AK-në ka paraqitur një ofertë nga "NTP AKOMA TE ISAKU", për pozicionet nr.33 si orman metalik, pozicioni me nr.32 kaseta metali, pozicionin nr.11 karrige statike për palë dhe një karrige organometrike.

Shih në vijim ofertën e cila është ofruar në sqarime nga ana e OE " Mobelland".

NTP AKOMA TE ISAKU

OFERTE

Emri:	MOBELLAND SHPK	Adresa:	
Adresa:	Xhavit Sylaj p.n.	Magjistralja PrishtinëFerizaj,Km5,Preoce,10500	
Nr Unik:	810107393	Nr Unik: 811311373	
DATE: 15.12.2021			

Shifra	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Totali
5176	Karrika Z16C (Orgonmetrike)	Cope	1	190.00	190.00
6555	Karrika 809 (Statike per pale)	Cope	1	90.00	90.00
	Ormana metali	Cope	1	28.00	28.00
	Kaseta metali	Cope	1	26.00	26.00
					334.00

Nenshkrimi:

Lidhur me autenticitetin e ofertës, eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit AK-ja konform nenit 72 të LPP-së të kërkon sqarime nga operatori ekonomik i cili e ka lëshuar këtë ofertën dhe të verifikoj çmimet.

Gjithashtu OE "Mobelland" në sqarimet e dhëna për AK-në ka ofruar disa fatura të viteve të më hershme, në të cilat janë pasqyruar çmimet për materialet e kërkuara në Aneksin 1 të DT-së, andaj eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit AK-ja konform nenit 72 të LPP-së të verifikoj çmimet e ofruara ngase prej vitit te faturave të paraqitura deri me tani në treg kemi ngritje enorme të çmimeve.

Po ashtu edhe për pozicionin 17 të paramasës (frigorifer i vogël 50 L), OE "Mobelland" ka ofruar sqarime për AK-në ku ka bashkangjitur një Ofertë (pro faturë e thjeshtë) e cila mban çmimin e artikullit 20.00 euro, ndërsa në paramasën e OE "Mobelland" ky artikull është ofruar me 25.00 euro, andaj eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit konform nenit 72 të LPP-së, AK-ja të verifikoj pro faturën si dhe të konstatoj relevancën

e çmimit të tregut me çmimin e ofruar nga OE “Mobelland”. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankue është i bazuar.

Shih në vijim pro faturën e ofruar:

OFERTA PRO FATURE

V. Shala 70 536 536

"MOBELLAND" SHPK

Nr. ren.	Përshkrimi i mallrave dhe i shërbimeve	Njës. mat.	Sasia	Çmimi Euro	Vlera totale Euro
a	b	c	d	e	f
1.	FRIGORIFER VCOOL		1		20
2.					
3.					
4.					
5.					
6.					
7.					
8.					
9.					
10.					
11.					
12.					
13.					
14.					
15.					
16.					
17.					
18.					
19.					

TOTALI:

V.V.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 5

OE ankues konstaton që AK-ja ka shkelur nenin 61 të LPP-së pasi nuk ka kryer ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në përputhje me këtë dispozitë ligjore bazuar në kërkesat tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit si dhe rregullat për tender jo normalisht të ulët. Ne si OE "Trendy Home", kemi çmime të cilat nuk janë jo normalisht të ulëta dhe as çmime jo normalisht të larta, por janë çmime të tregut të cilat mund të verifikohen tek bashkëpunëtorët dhe partnerët tanë, ku ju kemi dërguar dëshmitë sipas kërkesës për sqarime të tenderit.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja konform paragrafit 1 të nenit 61 i ka kërkuar sqarime OE dhe pas sqarimeve të pranuara nuk është bindur me arsyeshmërin e shpjegimeve të pranuara nga OE ankues, mirëpo eksperti shqyrtues mendon se AK-ja nuk ka dhënë ndonjë shpjegim se si i ka verifikuar këto çmime dhe eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit AK-ja të respektoj në tersi paragrafët e nenit 61 të LPP-së.

Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE "MOBELLAND" Sh.p.k Suharekë

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues "Mobelland" sh.p.k thotë se AK-ja na ka shpallur si të pa përgjegjshëm me arsyetimin se sqarimet tona të ofruara të dt. 26.01.2022 nuk janë të mjaftueshme dhe nuk arsyetojnë çmime jo normalisht të ulëta në shumë pozicione dhe shumë pozicione me çmime shumë të larta në raport me çmimet e tregut. Gjithashtu ka cekur se në shumicën e pozicioneve (të specifikuar edhe në letrën standarde për informata sqaruese keni ofruar çmime spekulative respektivisht çmime jo normalisht të ulëta apo çmime shumë të larta në raport me çmimet e tregut në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së. Çmimi jo normalisht i ulët dhe neni 4 i RROUPP pika 4.2 të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Konsiderojmë që konkluzioni i AK-së i paraqitur më lartë është vetëm arsyetim fiktiv me të cilin AK-ja me rastin e vlerësimit të tenderit, duke parë që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat në dosje të tenderit si dhe kemi ofruar çmimin e tenderit më të lirë në mesin e tenderuesve pjesëmarrës, me qëllim që t'ia jep edhe një shans ndonjë OE të paracaktuar, na shpall si të pa përgjegjshëm dhe anulon tenderin në fjalë. Andaj del se AK-ja gjatë vlerësimit të tenderit nuk i ka trajtuar

OE në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe nuk ka vepruar në mënyrë transparente dhe kjo paraqet shkelje të nenit 7 të LPP-së.

Për këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se mospranimi si të mjaftueshme i sqarimeve të dhëna nga OE ankues për AK-në është në diskrecion të vetë AK-së. Megjithatë edhe pse AK-ja nuk i ka marrë si të mirëqena dhe të pa pranueshme arsyetimet e dhëna nga OE ankues, AK-ja nuk ka dhënë ndonjë përshkrim apo ndonjë dëshmi se si i ka cilësuar si çmime jo normalisht të ulëta apo të larta, pozicionet për të cilat ka kërkuar sqarime. Ndërsa lidhur me trajtimin e barabartë të gjithë OE-ve, eksperti shqyrtues mendon se AK-ja i ka trajtuar njëlloj të gjithë duke iu kërkuar sqarime të gjithë operatorëve ekonomik pjesëmarrës.
Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues thekson se AK-ja ka shkelur dispozitat e Nenit 1 të LPP-së pasi që ka refuzuar ofertën tonë e cila ka qenë oferta më e lirë, ndërsa dispozitat e këtij neni kanë paraparë që qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Në bazë të këtyre rregullave AK-ja duhet ta merr vlerën për paranë e që oferta jonë do të plotësonte një kërkesë të tillë.

Për pretendimin ankimor të lartcekur eksperti shqyrtues sqaron se në nenin 31.1 të dosjes së tenderit është përcaktuar kriteri i dhënies së kontratës i cili është: "Tenderi i Përgjegjshëm me Çmimin më te ulët me Poentim". Andaj duke pas parasysh qëllimin e Nenit 1 të LPP-së , AK-ja u ka kërkuar sqarime OE-ve duke rrespektu procedurat e ndjekura, duke respektuar të drejtat dhe detyrimet që do të përmbushën, të cilat dalin nga Neni 1 i LPP-së. Andaj pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues thekson se komisioni i vlerësimit është caktuar me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KGJK-së. Pasi analizuam vendimin, vërejmë që i njëjti është i mangët dhe në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të prokurimit pasi që në pikën 1 të vendimit anëtarët e komisionit janë caktuar në bazë të pozitave të punës dhe jo në bazë të profesionit të cilin e zotërojnë.

Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar.

Për këtë pretendim ankimore eksperti shqyrtues sqaron se krijimi i komisioneve të vlerësimit është i paparë në neni 40 të RROUPP-së, gjithashtu janë të paparë edhe kushtet e përshtatshmërisë së anëtarëve të komisionit të cilët vlerësojnë konform kërkesave të përcaktuar në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj në këtë pikë eksperti shqyrtues nuk sheh ndonjë arsye të bazuar për kontestim të komisionit të vlerësimit.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE ankues thotë se në raportin e vlerësimit të tenderit si dhe në vendimin e AK-së, komisioni vlerësues nuk ka dhënë kurrfarë sqarimi si dhe nuk ka bërë kurrfarë analize për të dëshmuar se si ka ardhur deri tek konkluzioni që ne kemi ofruar tender jo normalisht të ulët apo se kemi ofruar çmim të lartë në disa artikuj. Gjithashtu komisioni nuk ka dhënë kurrfarë sqarimi se me cilin treg i ka krahasuar çmimet tona, apo nga cilat referenca i ka marrë çmimet për ti krahasuar me ofertën tonë. Komisioni vlerësues ka shkelur rregullat për tender jo normalisht të ulët konkretisht nenin 4.4 me nënparagrafët 4.4.1;4.4.2;4.4.3;4.4.4, pasi që nuk ka ofruar kurrfarë dëshmie se ka marrë për bazë ekonomin e procesit të prodhimtarisë të inventarit të kërkuar, nuk i ka marrë për bazë zgjidhjet teknike të ofruar nga ne, nuk i ka marrë për bazë kushtet e veçanërisht të favorshme që janë në dispozicionin tonë për furnizimin e produkteve si prodhues i gjithë inventarit të kërkuar si dhe nuk e ka marrë për bazë origjinalitetin e furnizimeve.

Pas analizimit të dokumentacioneve të ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja ka kërkuar sqarime për çmime jo normalisht të ulëta dhe çmime të larta për disa pozicione të

tenderit. OE i është përgjigjur kërkesës së AK-së dhe ka elaboruar çmimet e ofruar për këto pozicione të kërkuara nga AK-ja, po ashtu ka paraqitur disa dëshmi të zbërthyera se si ka arritur tek ato çmime. Mirëpo ky arsyetim nuk është marrë parasysh nga ana e AK-së.

Në dokumentacionin e ofruar në E prokurim, AK-ja nuk ka dhënë ndonjë shpjegim se si ka ardhur deri tek konstatimi për çmime jo normalisht të ulëta dhe çmime të larta në krahasim me çmimet e tregut, për faktin se nuk kemi parë ndonjë dëshmi nga ana e AK-së që ka verifikuar këto çmime.

Andaj, eksperti shqyrtues vlerëson se gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit AK-ja të veproj në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së si dhe me rregullat për tender jo normalisht ë ulët.

Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 5

OE ankues thotë se në specifikat e tenderit AK-ja ka kërkuar material tepër të veçantë, p.sh në artikullin 21-Vitrinë me 2 dyer për zyre është kërkuar nga AK-ja që pesha specifike e vitrinës të jetë 850kg/m3. Duke pasur parasysh këtë kërkesë edhe pse kjo vitrinë është me dimensione më të vogla se pozicioni 19 dhe 20 materiali i ndërtimit është 15 fish më i shtrenjtë për shkak të nevojës së presimit tepër të lartë të materialit për të arritur peshën specifike të kërkuar. Prandaj është normale që kur kërkohet një material me specifika të tilla, çmimi do të del më i lartë se disa artikuj tjerë për të cilat janë kërkuar specifika të rëndomta. Pra në bazë te specifikave të kërkuara nga vet AK-ja janë dhënë edhe çmimet. Gjithashtu ka pasur edhe artikuj tjerë të cilët në bazë të specifikave të veçanta është dashur që të ofrohen çmime në bazë të materialit të tregut të inventarit. Andaj AK-ja ka bërë edhe shkelje të nenit 27 të LPP-së, paragrafi 1 dhe neni 18 të rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues në lidhje me këtë pretendim ankimor ka mundur të ankohet në AK sipas paragrafit 3.1 të nenit 108/A, ku është e përcaktuar koha se kur operatorët ekonomik kanë të drejt të paraqesin ankesë në lidhje me dokumentet e tenderit si p.sh ne këtë rast për artikullin me nr. 21. Andaj konsideroj se operatorët ekonomik duhet t'i përmbahen kërkesës së dosjes së tenderit. Andaj pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 6

OE ankues thotë se në bazë të fakteve të paraqitura më lartë , konsiderojmë që komisioni i vlerësues, nuk e ka kryer detyrën e vetë në përshtatje me vendimin për caktimin e tyre pasi që ka bërë një vlerësim jo të drejtë dhe të njëanshëm të tenderit duke shkelur nenin 59 të LPP-së për arsye se ne kemi dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë tek AK-ja, ndërsa komisioni vlerësues na ka konsideruar si të pa përgjegjshëm dhe ka vlerësuar se tenderi duhet të anulohet.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja konform nenit 59 të LPP-së gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, i ka kërkuar sqarime OE ankues për disa pozicione të cilësuara nga AK-ja si çmime jo normalisht të ulëta dhe për disa si çmime të larta në krahasim me çmimet e tregut. OE ankues i është përgjigjur AK-së për pozicionet e kërkuara, duke elaboruar në mënyrën e tij çmimet për pozicione, si dhe ka bashkangjitur Faturë, pro faturë, ofertë. Ndërsa Arsyeshmëria e këtyre çmimeve nuk është marrë parasysh nga ana e AK-së.

Andaj eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit AK-ja konform dispozitave te nenit 72 të LPP-së, t'i verifikoj çmimet e tregut me çmimet e ofruara nga OE ankues dhe ekzaminimin, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 7

OE ankues thekson se në dispozitat e nenit 62 të LPP-së si dhe në dispozitat e nenit 44 të RROUPP është paraparë ndërprerja e procedurave të prokurimit. Sipas këtyre dispozitave në asnjërën nga pikat nuk është paraparë që të anulohet tenderi pas hapjes së tij për shkak të çmimeve jo normalisht të ulëta.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se në njoftimin mbi vendimin e AK-së si arsye e anulimit të aktivitetit të prokurimit është theksuar se asnjëri prej tenderëve të pranuara nuk është i përgjegjshëm. Andaj kjo nuk është e paraparë në ligjin primar konkretisht në nenin 62 të LPP-së, por është paraparë në legjislacionin sekondar nenin 44.5 pika (ii) të RROUPP.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 8

OE ankues thotë se AK –ja ka bërë shkelje të nenit 61 të LPP-së si dhe nenit 4 pika 4.6 të Rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit pasi që pas sqarimit ka konsideruar që sqarimi jonë nuk mjafton, tenderin tonë e ka anuluar dhe nuk e ka njoftuar KRPP-në, në përputhje me nenin 61 të LPP-së duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP-ja, "Njoftim për refuzim të tenderit abnormalisht të ulët" brenda dy dite nga dita e vendimit sepse KRPP-ja në bazë të kompetencave të veta ka mundur që ta hetojë këtë rast dhe të rekomandoj që mos të anulohet tenderi pasi që kemi ofruar sqarimin e mjaftueshëm për çmimet tona të paraqitura në tender dhe nuk do të kishte ardhur deri te paraqitja e ankesës.

Për këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues thekson se pas sqarimeve të marra nga OE ankues, dhe përgjigjes në kërkesën për rishqyrtim AK-ja ka konfirmuar anulimin e aktivitetit të prokurimit, ndërsa në dokumentet e ofruar në E prokurim nuk është gjetur ndonjë dokument që AK-ja e ka njoftuar KRPP-në në lidhje me cilësimin e tenderit jo normalisht i ulët ashtu siç parashihet në dispozitat ligjore të nenit 61 të LPP-së. Andaj eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit AK-ja të respektoj në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Trendy Home" sh.p.k Prizren dhe OE " MOBELLAND" Sh.p.k Suharekë të aprovohen si pjesërisht të bazuara, dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - KGJK

Panelit Shqyrtues - OSHP

OE ankues - "Trendy Home" sh.p.k Prizren dhe OE " MOBELLAND" Sh.p.k Suharekë